



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.220/2025**

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 29.01.2025, mori këtë:

### VE N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa A.nr.220/2025 e datës 27.01.2025, e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025

### A r s y e t i m

Me datë 27.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën pretendohet se aktivistë të PDK, kanë vërejtur së në rrugën "UÇK", në Komunën e Prishtinës, në hapësirat private/veturat e ndryshme, të parkuara në këtë rrugë, janë vendosur njoftime për tubimin në lagjen Tophane, për datën 27 janar, në SHFMU" Meto Bajraktari", për në ora 20:00. Vendosjen e njoftimeve nga ana e aktivistëve të Lëvizjes Vetëvendosje, në hapësirën private, pa lejen paraprake apo pëlqimin paraprak të tyre, PDK vlerëson se janë konsumuar të gjitha elementet e veprimit të ndaluar, të përcaktuar në nenin 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, PDK konsideron se LVV, duhet që të argumentoj pronësinë e veturave përkatëse që vërehen në këtë fotografi dhe së bashku me këtë dëshmi, të bashkëngjisë edhe pëlqimet përkatëse të siguruara nga ana e tyre. Bashkangjitur në ankesë në cilësinë e provës janë disa fotografi që dëshmojnë shpërndarjen e njoftimeve në xhamat e përparme të veturave.

Më datë 28.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 29.01.2025 në ora 10:00. Në përgjigje në ankese theksohet se e kundërshtojmë ankesën për arsye se konsiderojmë se e njëjta vetëm tekstualisht mbështetet në fakte, ndërsa nga provat materiale të bashkangjitura nuk mund të

vërehet ndonjë aktivitet i pjesëtarëve të Vetëvendosjes! në vendosjen e këtyre njoftimeve, dhe konsiderojmë se vendosja e njoftimeve, për deri sa nuk janë të vendosura në mënyrë statike është një inskenim nga subjektet kundërshtare, gjithashtu tentimin e ankuesit nga pika 5 e ankesës, për arsye se edhe po që janë vendosur këto afishe nga subjekti LVV, nuk do të thotë që kërkohet leja e pronarëve, pasi që ideja e ligjvënësit në momentin kur ka paraparë lejen nga pronari, fjala ka qenë për postërë statik e jo për njoftime që nuk shërbejnë për fushatën zgjedhore, ashtu siç ligji e sanksionon.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se Subjekti Politik e Lëvizja Vetëvendosje, ka shpërndarë material zgjedhor/njoftime për tubimin politik, në hapësirat private/veturat e ndryshme, të parkuara në këtë janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 i cili përcakton” *Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisë si në vijim, paragrafi 2.2 vendosa e njoftimeve, pllakateve dhe postereve , ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat e trafikut publik, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna, ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizata ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”,* pasi që në fotografit e bashkangjitura në ankesë shihen vetëm disa njoftime të shpërndara në hapësirat private/veturat e ndryshme, të parkuara në këtë rrugë, për të cilin veprim nuk mund të identifikohet fakti se kush i ka vendosur këto njoftime në vetura të parkuara.

Në bazë të provave të bashkangjitura shkresave të lëndës dhe pretendimet e palës ankuese paneli vlerësoi se pretendimi ankimor për shpërndarjen e njoftimeve për tubim publik në hapësirat private/veturat e ndryshme të parkuara, janë të paqëndrueshme dhe si të tilla Paneli i refuzoi për faktin se subjekti politik PDK nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi, nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime janë ndërmarr nga subjekti politik kundër të cilit është paraqitur ankesa, për të ardhur në përfundim se janë bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të Nenit 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Kështu që paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar kanë shpërndarë material zgjedhor/njoftime për tubimin politik, në hapësirat private/veturat e ndryshme.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.220/2021 më datën 29.01.2024

Kryesues i Panelit  
Skender Çoçaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.